

VENDIM
Nr. 243, datë 21.4.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 397, DATË 13.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR UNAZA LINDORE LOTI 3’, TIRANË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 397, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 3, shifra “... 1 070 816 707.57 (një miliard e shtatëdhjetë milionë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatë pikë pesëdhjetë e shtatë) ...” ndryshon dhe bëhet “... 1 231 857 207.57 (një miliard e dyqind e tridhjetë e një milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatë pikë pesëdhjetë e shtatë) ...”.

b) Në pikën 4, shifra “... 1 070 816 707.57 (një miliard e shtatëdhjetë milionë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatë pikë pesëdhjetë e shtatë)” zëvendësohet me “... 1 231 857 207.57 (një miliard e dyqind e tridhjetë e një milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatë pikë pesëdhjetë e shtatë) ...” dhe, në fund të kësaj pike, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“- 161 040 500 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milionë e dyzet mijë e pesëqind) lekë, nga buxheti i miratuar në programin e “Transportit rrugor” në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin buxhetor 2021.”.

c) Në pikën 5, shifra “... 100 000 (njëqind mijë) ... ndryshon dhe bëhet “... 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) ...”.

ç) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA DISA
 NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 397, DATË 13.5.2020, “PËR SHPRONËSIMIN
 PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
 PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR UNAZA
 LINDORE LOTI 3, TIRANË”, TË NDRYSHUAR

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m ²)	Sipërfaqe shpronësimi		Vlera totale (lek)	SHËNIM
						Truall (m ²)	Çmimi truallit/m ²		
1	Genti Haxhi Sauku, Artan Haxhi Sauku, Merita Haxhi Bruci (Sauku) Hana Haxhi Sauku	8180	7/647	Truall	8,993.1	5150	31,270.0	161,040,500.0	Seksioni D: Mbi këtë truall pozicionohen ndërtesat me nr. 7/671-nd., 7/664-nd., 7/650/nd., 7/649nd., 7/648/nd. dhe nr. 7/641 nd. Seksioni E: Vendoset sekuestro konservative nga shoqëria “Besa” sh.p.k., në favor të Banka Credins dhe masa sekuestro konservative.
VLERA TOTALE								161,040,500.0	